

Komunikate per shtyp

Sektori televiziv shqiptar ende ne gjendje anarkie

Tirane, Londer dhe Budapest, 2 tetor 2008 – Sipas nje raporti te ri te Institutit per Shoqeri te Hapur (OSI,) media elektronike ne Shqiperi vazhdon te jete e pakonsoliduar. Ky raport, pjese e serise ‘Televizioni ne Europe: raportet vijuese 2008’, shpreh shqetesim per qendrueshmerine e sektorit shqiptar te transmetimeve, i cili eshte i mbipopulluar. Gjithashtu raporti ngre pyetje per te ardhmen e transmetuesit publik, i cili ka mbetur ne tranzicion. Se fundmi, raporti paralajmeron per nje gjendje qe prek cilesine e informacionit qe u percillet qytetareve shqiptare.

Raporti, i cili vijon pas monitorimit te OSI ne 2005, shpreh shqetesim per pakesimin e fondeve qe kane sjelle nje ngelje ne vend te reformes ne Radio-Televizionin Shqiptar (RTSH) dhe nje renie te vazhdueshme te cilesise se programeve. Gjithashtu raporti nenvizon situaten jonormale kur fondet per RTSH, te marra nga taksa e aparatit, jane te paqarta, si ne sasi, ashtu edhe ne perdorim.

Persa u perket televizioneve private, Shqiperia eshte prove qe thjesht sasia e kanaleve nuk mjafton per te prodhuar nje treg televiziv. Ky sektor karakterizohet nga mungesa e transparences se pronesise dhe nga burimet misterioze te financimit, te cilat me shume gjasa vijne nga interesat e tjera te pronareve.

Mungesa e mbrojtjes ne pune vazhdon ta pengoje profesionalizmin e medias private dhe transmetuesit publik. Kushtet e punesimit jane te tilla qe “vete-censura eshte rregulli nder gazetaret dhe jo vete-rregullimi”, thote autorja e raportit Ilda Londo.

Transmetimet numerike jane mjaft te zhvilluara, pavaresisht mungeses totale te rregullimit ne kete fushe deri tani. Duke pretenduar me shume se 120,000 abonente (ne nje popullsi prej rreth 3 milione banoresh), kompania DigitAlb ka nisur transmetimet qe ne 2004 pa licence. Ne kete menyre, peizazhi audioviziv shqiptar po pervijohet nga nje operator privat me burime shume me te medha se ato te transmetuesit publik, siç u duk qarte kur DigitAlb bleu te drejtat e transmetimit per Kupon e Botes ne 2006.

Dobesia e vazhdueshme e rregullatorit te medias elektronike, Keshillit Kombetar te Radios dhe Televizionit, nuk te shtyn te besosh qe do ta perballoje me sukses sfiden e licensimit numerik.

Persa i perket studimeve per audiencen, Shqiperia mbetet nje vrime e zeze. Pa pasur nje studim sistematik dhe te besueshem te tregut, do te jete e pamundur te behen analiza plotesisht te besueshme te sektorit audiovizual – si dhe do te jete mjaft e veshtire te thithen investime te huaja.

Ne nje aspekt me pozitiv, ne tre vitet e fundit Shqiperia ka miratuar nje sere masash legjislativ, te cilat e afrojne me standartet nderkombetare, si dhe me rregullat per shperndarjen e reklames shteterore, siç ishte rekomanduar ne raportin e OSI ne 2005. Ndihamat shteterore per median – ne

formen e reklames dhe kontratave per informim te publikut – tashme botohen ne buletine te botuara nga Agjencia e Prokurimit Publik.

Qeveria, KKRT, si dhe organe te tjera duhet te garantojne transparencen e pronesisë dhe financimeve ne media. Gjithashtu qeveria duhet te zbatoje Kodin e Punes ne organizatat e medias. Mbledhja dhe shpenzimi i te ardhurave nga taksa per aparatin gjithashtu duhet bere transparente. Administrata dhe stafi i RTSH duhet te perpiqet te permiresoje cilesine e programit. Se fundmi, komuniteti nderkombetar duhet te vazhdoje te aftesoje shoqatat e gazetaeve, te cilet nga ana e tyre duhet te nxisin fuqimisht zbatimin e kodit te etikës qe u hartua ne 2006.

Shenim per redaktoret

Ky raport eshte pjese e serise se monitorimit, “*Televizioni ne Europe: Raportet Vijuese 2008*”. Seria perditeson analizen ne nente nga njezet vendet te cilat u mbuluan nga seria e raporteve te 2005, “*Televizioni ne Europe: rregullimi, politikat dhe pavaresia*”: Shqiperia, Bullgaria, Republika Çeke, Italia, Lituania, Maqedonia, Polonia, Rumania dhe Sllovakia.

Te dyja serite e raporteve u prodhuan nga Programi per Monitorim dhe Avokaci te BE (EUMAP) i Institutit per Shoqeri te Hapur dhe Network Media Program (NMP) i Fondacionit per Shoqeri te Hapur, ne bashkepunim me eksperte dhe organizata te shoqerise civile lokale. Teksti i plote i te gjitha raporteve, si dhe permbledhja europiane, do te botohen ne anglisht dhe te perkthyer ne <http://www.mediapolicy.org>.

Raporti per Shqiperine i 2008, si dhe ai i 2005, u hartua nga Ilda Londo, Instituti Shqiptar i Medias. Instituti Shqiptar i medias punon me trajnimin e gazetaeve, perqendrohet ne krijimin e debateve per politikat e medias dhe ne hartimin e hulumtimeve per median, si dhe boton libra per gazetarine. Raporti per Shqiperine do te botohet ne faqen e Institutit: <http://www.institutedia.org>.